



Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rrijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS



ATELIER 4
ARCHITECTURE • ENGINEERING • CONSULTING



Funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS



RAPORT MEKANIK HAMAMI DURRES





Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rrijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS



TABELA E PERMBAJTJES:

1.	IMPIANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI	3
1.1	SINJALISTIKA.....	3
1.2	IMPIANTET E SHUARJES ME BOMBULA PORTATIVE	4
2.	IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJE SANITAR.....	5
3.	SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJERAVE TE ZEZA.....	6
4.	SISTEMI I NGROHJES.....	6



Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rrijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS



ATELIER 4
ARCHITECTURE • ENGINEERING • CONSULTING

MUNDESITE E NDRHYRJEVE PER RIKONSTRUKSIONIN DHE NDERTIMIN E IMPIANTEVE MEKANIKE.

1. IMPIANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Impianti i mbrojtjes nga zjarri ka per qellim:

- Mbrojtjen e personave prezent ne rast te shfaqjes se zjarrit, tymit, etj
- Mbrojtjen e materialeve dhe orendive te ndodhura ne objekt
- Mbrojtjen e strukture konstruktive te objektit.

Impianti i zjarrit eshte pershtatur ne maksimum me objektin dhe me funksionin e tij.
Projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit ndahet ne **Masa Pasive** dhe **Masa Aktive**.

Masat pasive përbëjnë tërësinë e masave arkitektonike dhe konstruktive duke zgjidhur dhe përcaktuar drejt rrugët e shpëtimit në koridore, shkallë, daljet e emergjences, shkallë të brendshme të mbrojtura, ashensorë, sigurimin e kompartimenteve të mbrojtura nga zjarri dhe tymrat nëpërmjet strukturave ndërtimore si mure, tavane, dysheme, dyer etj, me rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj zjarrit (REI), sipas normave etj. Rrugët e evakuimit dhe shpëtimit janë të plotësuar me sinjalistikën përkatëse sipas normave.

Masat aktive përbëjnë qellimin e projekteve mekanike dhe konsiston në ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit.

Për këtë qëllim janë parashikuar shuaresit e zjarrit portativ, te cilat jane me pluhur dhe me CO₂, në përputhje me kategoritë e zjarrit.

1.1 SINJALISTIKA

Nje element shume i rendesishem ne mbrojtjen kundra zjarrit eshte vendosja e sinjalistikes perkatese. Kjo perbehet nga nje numer i madh tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese, si p.sh:

Tabela paralajmëruese - jane tabelat qe tregojne ndalimin e ndezjes se zjarreve, ndalimit te përdorimit te ujit per shuarje e tij, etj.

Tabela treguese – sic jane drejtimet e daljes neper koridore, neper shkalle, vendosja e hidranteve dhe te bombolave etj.



Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rrijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



ATELIER 4
ARCHITECTURE • ENGINEERING • CONSULTING

Tabelat vepruese – sinjalizimi nepermjet butonit te alarmit, ndërprerja e energjise elektrike etj.



Fig.1 Zbritje Shkallesh



Fig.2 Drejtim dalje



Fig.3 Ndalim i shuarjes me uje




Fig.4 Rezik tension elektrik



Fig.5 Buton alarmi



Fig.6 Fikse portative me CO₂

1.2 IMPIANTET E SHUARJES ME BOMBULA PORTATIVE

Bombulat portative sherbejne per shuarjen e zjarrit te mundshem ne objekt.

Bombolat do te perdoren me CO₂ dhe me pluhur, ne varesi te zonave dhe objekteve qe do te mbrojne. Ne menyre qe gjate kohes se fikjes se zjarrit mos te demtohen nga perdorimi i gabuar i llojit te fikses.

Numri dhe dimensionimi i bombolave per shuarjen e zjarreve eshte percaktuar ne perputhje me normat / standardet perkatese. Perdorimi i tyre dhe kontrolli per sigurine e tyre duhet te behet sipas rekomandimeve te prodhuesit.



Funded by
the European Union
22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."
22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rrijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



	Klasa:				
Emertimi i cilindrit(fiks) antizjarr					
Fikse me pluhur	PG	✓	✓	✓	
Fikse me pluhur (per zjarre te shkaktuar nga metale)	PM				✓
Fikse me pluhur (me pluhur special)	P		✓	✓	
Fikse me Dioxide carbon (CO2)	K		✓		
Fikse me shkume	S	✓	✓		



Fig.7 Bombol portative CO₂



Fig.8 Fikse portative me pluhur

2. IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJE SANITAR

Sistemi i furnizimit me uje sanitar do te sherbeje per te siguruar ujin e ftohte nga linja ekzistuese e ujesjellsit te pompa e riqarkullimit dhe pas kesaj te siguroje shperndarjen e ujit ne pajisjet dekorative. Sistemi i tubave te ujit sanitar do te plotesoje kerkesat e normave dhe standarteve perkatese. Tubat per furnizimin me uje do te jene tuba Pex-Al-Pex, te cilat plotesojne te gjitha kerkesat higjieno -sanitare, sipas standarteve perkatese te ketij sistemi.

Rezerva ujore e llogaritur ne projekt eshte sasia minimale e nevojshme per te kryer riqarkullimin e ujit nga rezervuari nepermjet pompes, tek lavamanet.



Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



ATELIER 4
ARCHITECTURE • ENGINEERING • CONSULTING

3. SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJERAVE TE ZEZA

Ky sistem vetëkuptohet, do të shërbejë për shkarkimin e ujerave nga pajisjet dekorative. Uji që rrjedh nga lavamani me anë të tuabve PP (polipropilen i termostabilizuar në temperaturë të lartë), të shtruar në dysheme të objektit dhe dergohet në "gropë" e ndërtuar në dysheme me dimensionet e përcaktuara në projekt. Kjo gropë shërben për akumulimin e një rezerve ujore në të cilën furnizohet me ujë pompa që dergon ujin në lavaman. Ky sistem do të funksionojë si një sistem riqarkullimi dhe të bëjë të duket që lavamanet shkarkojnë ujë pa ndërprerje. Shkarkimi i gropës për akumulimin e ujit bëhet nëpërmjet një tubi PPR me një saracineshë normale dhe mbështetje dhe në momentin që duhet të shkarkojmë gropën, bëjmë hapjen e saracineshës duke shkarkuar ujin në rrjetin e ujerave të shiut.

- Sistemi i drenazhimit të themeleve

Ky sistem do të shërbejë për drenazhimin e themeleve të objektit, në mënyrë që të bëhet heqja e ujerave nëntokësore të cilat mund të ndikojnë negativisht për objektin. Shkarkimi i ujerave nëntokësore do të bëhet me vetërrjedhje në rrjetin e ujerave të shiut, pa ndikuar "prishur" stabilitetin e këtyre ujerave. Tubi i drenazhimit do të jetë me vrima 360° dhe materiali i tipit do të jetë PP. Tubi i drenazhimit do të jetë i veshur me gjeotekstil dhe hapja e kanalit dhe shtraset në të cilën do të instalohet tubi do të jenë siç është treguar në seksionin e paraqitur në vizatim.

4. SISTEMI I NGROHJES

Sistemi i ngrohjes nga dyshemeja me panel elektrik radiant, do të shërbejë për krijimin e temperaturës me parametrat e kërkuar në ambientin e brendshëm të objektit. Fleksibiliteti në montim, thjeshtësi në komandim dhe kosto të ulët në investim dhe shfrytëzim, e bëjnë këtë sistem ideal për tu përdorur në ambientet që kërkojnë vetëm ngrohje dhe kanë vështirësi me pozicionimin e pajisjeve të jashtme siç mund të jetë pompa nxehtësie kalldaje etj.

Sistemet e ngrohjes nga dyshemeja me panel elektrik radiant, funksionojnë si një "batanie" elektrike, që bëjnë të mundur ngrohjen e gjithë ambientit me një temperaturë konstante në të gjithë sipërfaqen. Sistemi që ne kemi përdorur është me vetëregullim temperaturë (e ul dhe e ngrë temperaturën në varësi të kërkesës, mund të instalohet në çdo lloj sipërfaqe dhe nuk shfaq probleme me mbinxhjen.

Keto sisteme përbehen nga kabulli elektrik i ndërtuar me rrjetin plastik, termostati



Funded by
the European Union

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Provision of Consultancy for Design services for EU4CULTURE Project - Support for revitalization of cultural heritage sites and monuments affected by Earthquake in Albania."

22644-001_ALB_EU4C_RFP_01 - "Sigurimi i Konsulencës për Shërbimet e Projektimit për Projektin EU4CULTURE - Mbështetje për rijetëzimin e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga Tërmeti në Shqipëri."



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS



ATELIER 4
ARCHITECTURE • ENGINEERING • CONSULTING

dhe sensori i temperatures. Panelet elektrike punojne me temperatura te ulta dhe kjo ben qe i gjithe sistemi te funksionojne ne kushte ideale pa shqetesuar personat qe qendrojne ne keto ambiente.

Per te garantuar performacen dhe jetegjatesine maksimale te paneleve elektrike, ato do te instalohen sipas udhezimeve dhe kushteve teknike qe jepen ne specifikimet teknike nga prodhuesi i tyre. Gjithashtu theksojme se temperatura e punes do te regjistrohet sipas udhezimeve te prodhuesit te produktit, duke patur parasysh edhe shtresen nen te cilen eshte aplikuar.



Fig.9 Panel radiant elektrik